REPUBLIKA KOSOVA
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
313/20
02.06.20

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Visar Bibaj – Exp shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit ***26.05.2020***	Data e dorëzimit të raportit **02.06.2020**

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 18.05.2020, OE "Central Group Company"shpk & "El- Bau"shpk"- Gjilan , ka parashtruar ankesë me nr: 313/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Elektro –GG" shpk, idhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me material Elektrik" me nr. të prokurimit: 704033736-20-252-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –KRU Prishtina.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 80 000.00 €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2. PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 Qëllimi
Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi
Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e kontratës

DEKLARATA DETALE E ANKESES

Ne si Grup i Operatoreve Ekonomik kemi ofertuar ne ketë projekt 'TURNIZIM ME MATERIAL ELEKTRIK" me nr. te prokurimit 704033736 20 252 1 2 I

Pretendimi nr. I

Nga data e ofertimit në ketë projekt kemi hasur në diskriminim dhe qellim i vazhdushëm i AK që me qdo kushte te na eleminoj ne si kompani, duke mos na dërguar procesverbalin e hapjes qe kemi cekur. Ak vazhdimishte eshte munduar te gjeje arsyje dhe duke na kërkuar sqarime shtese te pa baza si sqarim te dt. 06.03.2020, lidhur me referencat edhe pse te cilat i ka pasur te gjitha te skenuaraa te bashkangjitura ne dosjen e ofertimit , por ne me dt.08.03.2020, i kemi kthyer saqrim me referencat percjellse, po ashtu më dt. 30.03.2020, AK përseri me tendece ka kerkuar sqarime për të gjitha pozicionet se gjeja jemi me qmime jo normalishte te uleta . dhe ne më dt. 01.04.2020, i kemi kthyer përgjigjeje si në vijim :
Pasi që keni pranuarë Kërkesen tuj për informata mbi tendert jo-normalishte të ulët , më dt.30.03.2020, për aktivitetin Furnizim me Material Elektrik , ju informojnië si në vijim :

Ne qendrojmë mbrapa ofertës të cilën e kemi dorëzuar gjatë ofertimit ku çmimet me të cilat kemi ofertuar janë çmime të favorshme dhe na krijon një marzh të mirë të fitimit , por habitemi me ju si AK që të kërkoni Sqarime për gjitha pozicionet e paramasës , që i bie se fare nuk janë analizuar këto çmime nga AK, por ju duke krijuar konfuzion lidhur me kerkesen tuaj , duke u bazuar në Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Llët, në nin 3 , dhe duke e parë nga AK nenin 3.1 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar, kur të përmbushen te gjitha kushtet e mëposhtme:

i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëni;

ii. çminii i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;

iii, janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.
Pasi që këto kuhste asnjëra nuk janë përmbushurë ju si AK përdorni Nenin 3.2 Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht te ulët për arsye të tjera nga ato te parashikuara në paragrafin 3.1 të këtyre rregullave, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshniërinë e tenderëve të tille dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së.

Sipas këtij Nenin ju keni niundurë të kërkoni sqarime për pozicionet e caktuara të cilat nga ju si AK dhe koniision vlerësues keni mundurë ti konsideroni si çmime jo norinalisht të ulëta dhe ne si OE do të ju sigurohemi edhe dëshmi shtesë përpozicionet e caktuara por jo për gjitha paramasen sepse kjo i bie se nga AK fare nuk është analizuar oferta e jonë por vrehet çëllimi i qartë se kërkon vetëm një rasyje për të na eliminuar qka ëdhtë hera e dytë që kërkon saqarime të pa baza , ku heren e parë edhe pse i keni pasurë qarta dhe të bashkangjitura Referencat ju keni kërkuar Sqarime, ku po kërkoni nie çdo kuhstë të gjeni ndonjë preteks për eleniiniin.

Pretendimi nr. 2

Vlera e parashikuar nga AK për këte aktivitet ka qeneë 80,000.00 €, ndërsa Operatorin ekononiik të cilin e kanë shpallurë ësjhtë me vleren totale 93,025.80€, pra është tejkaluar vlera e parashikuar prej 13,025.80€.

AK pasi që ka parë se nuk janë plotësuar kushtet për tender Jo normalishte të ulet dhe duke insistuar qe me qdo kushte te na eleminoj perdor |Nenin 61, dhe duke mos analizuar fare paramasen na dergon te gjithe paramasen se gjeja kemi ofertuar me qmime jo normalishte te uleta. e cila nuk qendron pasi qe ne qendrohme mbrapa ofertes tone dhe ju kemi kerkuar qe te rritet vlera e sigurimit te tenderit.

Kërkojmë nga AK qe kerkesa jone te aprovohet, dhe lenda të kthehet ne ri vlersim dhe te rrespketohen kuhstet dhe kriteret e dosjes se tenderit per ofertuesin me qmimin me te ulet dhe te pergjegjeshem.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET (KERKESAT)

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

Deklarata nën betim se operatori përmbush kërkesën mbi përshtatshmërinë të ligjit të prokurimit , Ligji Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L068 dhe ligjin Nr. 05 L-092.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Deklarata e nënshkruar dhe e vulosur duke përdorur formën standarde në dosjen e tenderit-aneks 2

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

a.Operatori Ekonomik tenderueis duhet te jete i regjistruar si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në vendin e themelimit të operatorit ekonomik.

b. Operatori Ekonomik tenderues duhet te jete i regjistruar si parapagues per TVSH;

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

a.Kopje e regjistrimit të biznesit ne në regjistrin profesional, komercial dhe ose te korporatave,

b. Kopja e certifikates per TVSH

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

Operatori Ekonomik (Tenderuesi) me rastin e dorezimit te tenderit duhet te deshmojne se gjate tri vitet e fundit, duke filluar numerimi prapa nga data e njoftimit per kontrate, ka kryerfurnizime te ngjajshem ne vleren e se paku prej 100,000.00 €.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

(i) nese sherbimi është bërë për një autoritet kontraktues publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi ekzekutimi shërben nje Leter Reference te leshuar nga ana e AK OSE fletdergese fletpranim ose dokumentit per pranim teknik te pajisieve, e cila duhet te jete e nenshkruar nga ana e AK. (ii) nese sherbimi është bërë për një klient privat, për dëshmi të këtij ivrimi ekzekutimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga klienti qe evidenton nje ekzekutim të tillë.

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

Komisioni i vlerësimit propozon qe me kontrat te shpërblehet "Elektro GG shpk, per arsye se pas peshimit ne baz te rendesis se secilit artikull (%) ka rezultuar qe te jete OE me ofertën me te lire pra 78.01 €

Komisioni i vlerësimit e konsideron te eleminuar OE Selver Shala per arsye se i mungon sigurimi i tenderit ne pajtueshmëri me kërkesat e DT

Komisioni i vlerësimit te ofertave i konsideron te eleminuar OE NTSH Tap dhe OE Central Grup Company & El-Bau shpk, si tender jo normalisht te ulet.

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Vendimi me nr. 590/19, i datës 13.11.2019.

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

NA

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues – KRU - Prishtina, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është furnizim, me vlerë të mesme. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës, përkatësisht kundër arsyetimit te eleminimit ku AK ka potencuar se

parashtruesi i ankesës ka dorëzuar oferte financiare e cila ka pozicione me çmime jo normalisht te ulëta.

Përgjigje në Pretendimin ankimor-1: (Neni 113) Pretendimi i pare lidhur me mos dhënien e qasjes dhe atë ne procesverbalin e hapjes se ofertave, sqarojmë se AK, procedurën e prokurimit e ka iniciuar përmes platformës e- prokurimi, rrjedhimisht me tu hapur ofertat i njëjti është ngarkuar ne platforme elektronike dhe te gjeth ofertuesit e këtij aktiviteti te prokurimit kane pas qasje ne te.

Ndërsa lidhur me arsyetimin e eliminimit sqarojmë se AK, përgjatë vlerësimit te ofertave ka kërkuar qe te sqarohen te gjitha pozicionet e ofertuar a nga parashtruesi i ankesës. I njëjti OE përmes përgjigjes përveç sqarimeve është deklaruar se qëndron prapa ofertës financiare dhe pozicioneve, megjithatë AK nuk është bindur dhe disa nga pozicionet i ka trajtuar si jo normalisht te ulëta.

Eksperti shqyrtues vlerëson se kur AK-te përcaktojnë kriterin e dhënies "çmimi me i ulet **i peshuar"** (siç ka vepruar AK për ketë AP), duhet te përjashtohen dispozitat e nenit 61, te LPP-se dhe rregullat për çmime jo normalisht te ulët, pasi qe qëllimi i poen timit është eliminimi i çmimeve jo reale dhe nxjerrja e ofertës me te lire. Për me tepër edhe paneli shqyrtues përmes arsyetimit te vendimit me nr. 590/19, i datës 13.11.2019, qarte ka sqaruar kriterin e dhënies "çmimi me i ulet i peshuar".

Përveç kësaj AK, ka aplikuar peshimin ne baze te rëndësisë se secilit "Artikull", ku janë te përfshire gjithsej **278**, artikuj, dhe u është dhen vlera në përqindje, (përjashto artikullin me nr. rendor 122 "Tel fleksibil Pff 1.5 mm2" dhe 162 "Papaqë për kabllo 6mm2 CuM8", nuk është aplikuar peshe (%) fare), rrjedhimisht me peshim te tille pa bere gropëzimin e artikujve sipas rëndësisë dhe duke mos i peshuar te gjeth artikujt, nuk mund te ketë siguri qe do te arrihet qëllimi i prokurimit.

Neni 56, par 11 i RrUOPP-se, shprehimisht potencon : "*Kurdo qe Autoriteti kontraktues nuk dine sasitë indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet te përcaktoj peshët ne baze të rëndësisë se secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët...*".

Pra sipas asaj qe u përshkrua me larte AK, detyrimisht është dashur te peshoj edhe artikujt me nr. **122** dhe **162**. Për me tepër edhe sa sasia e çdo produkti ka qen e njoftuar, ku edhe është përshkruar tek aneksi 6 i dosjes se tenderit.

Përgjigje në Pretendimin ankimor - 1 Pretendimi tjetër ankimore ka te beje me ofertën e operatorit ekonomik te propozuar për dhënie te kontratës, ku potencohet se oferta e te njëjtit e tejkalon buxhetin e parapare nga AK. Ne i kemi kalkuluar ofertën financiare te te njëjtit operator ekonomik dhe ka rezultuar qe i njëjti ka tejkaluar buxhetin parapare nga AK, sipas sasive te përcaktuara ne aneksin 6, te DT-se, përkatësisht para masës dhe para llogarisë, prandaj AK, me rekomandimin e te njëjtit operator ekonomik nuk ka respektuar dispozitat e nenit 62, te LPP-se.

Përfundimisht, propozimi ynë për AK është qe përmes ri vlerësimit te ofertave qe:

- Te vlerësoi nëse me mos dhënie te peshës se te gjitha pozicioneve mund te arrihet qëllimi i prokurimit, apo edhe te ketë vlerësim real te ofertave
- Te vlerësoi ofertën financiare te operatorit ekonomik te rekomanduar për dhënie te kontratës pasi qe e njëjta e tejkalon buxhetin e AK-se, sipas sasisë se përcaktuar nga vet AK.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues te aprovohet si e bazuar, te anulohet njoftimi për dhënie te kontratës dhe lënda te kthehet ne Ri Vlerësim

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – KRU - Prishtina.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.

OE ankues - Central Group Company shpk & El –Bau shpk –